

Fillimi > -Kronikë

Si nisi konflikti me armë mes kreut të Njësisë Administrative Kallmet dhe 41-vjeçarit, policia e Lezhës zbardh ngjarjen. Ja gjendja e Simonit

02 Prill, 2022 09:29



Madhësia e tekstit: - +



LEZHË



Policia e Lezhës ka arrestuar kreun e Njësisë Administrative Kallmet dhe një 41-vjeçar pas përplasje me armë mes tyre ditën e djeshme për të cilën njofton se ka ndodhur për motive të dobëta.

Në vijim të veprimeve hetimore dhe operacionale të kryera për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes së ndodhur më datë 01.04.2022, në Kallmet të Lezhës, ku si pasojë e një konflikti me armë zjarri mbeti i plagosur kryetari i Njësisë Administrative Kallmet, shtetasi Besnik Simoni, shërbimet e Policisë, pas disa orë kërkimesh, kanë bërë të mundur kapjen dhe arrestimin e shtetasit Altin Marku, i cili në momentin e kapjes është konstatuar se ka qenë i plagosur me armë zjarri, për këtë arsye është transportuar në Spitalin e Traumës Tiranë.

Si rezultat i veprimeve të thelluara hetimore, u bë e mundur zbardhja e rrethanave të ngjarjes, ku ka rezultuar se:

Më datë 01.04.2022, rreth orës 13:15, në fshatin Kallmet, Lezhë, pas një konflikti për motive të dobëta, shtetasit e lartpërmëndur kanë qëlluar me armë zjarri pistoleta, në drejtim të njëri-tjetrit dhe për pasojë ka mbetur i plagosur shtetasi Besnik Simoni, i cili pasi ka marrë ndihmën e parë mjekësore në Spitalin Rajonal Lezhë, është transportuar në Spitalin e Traumës Tiranë, ku ndodhet në gjendje të rëndë shëndetësore, ndërsa shtetasi Altin Marku është larguar menjëherë nga vendi i ngjarjes, duke u fshehur për disa orë, deri sa është lokalizuar dhe është arrestuar nga shërbimet e Policisë.

Në përfundim të veprimeve u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve:

Altin Marku, 41 vjeç, banues në fshatin Kallmet-Lezhë, i dyshuar për veprat penale “Vrasja me dashje”, e mbetur në tentativë dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak”;

Besnik Simoni, 42 vjeç, banues në fshatin Kallmet, Lezhë, me detyrë administrator i Njësisë Administartive Kallmet, Bashkia Lezhë, i dyshuar për veprat penale “Vrasja me dashje”, e mbetur në tentativë dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak”.

Në cilësinë e provës materiale janë sekuestruar:


1 armë zjarri pistoletë, me një krehër me 6 fishekë, e cila dyshohet se është përdorur nga shtetasi Altin Marku, si dhe dy automjete.

Vijon puna për gjetjen e armës tjetër pistoletë, të përdorur gjatë konfliktit. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprime të mëtejshme.

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)


Etiketa: Altin Marku Besnik Simoni lezhe Plagosja

TË NGJASHME



Shpërthimi pranë një lokali në Lezhë, arrestohet shënjestra, në kërkim autori (Emrat)

02 Prill, 2022



Mbeti i plagosur gjatë shkëmbimit të zjarrit, kreut të Njësisë Administrative Kallmet i komunikohet arrestimi në spital

02 Prill, 2022


Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË




"Kërkoi të takonte prindërit e mi"/ Vajza nga Kosova rrëfen njohjen me Dumanin: Filluam të bashkëjetonim, nuk e dija se... Si ra pre e mashtërimit (DETAJE)

02 Prill, 2022




EMRI/ Në arrest shtëpie dhe shpërndante kokainë, arrestohet 46-vjeçari në Tiranë

02 Prill, 2022



Gjykata e Elbasanit jep masat: Detyrim paraqitje për të dashurën e Dumanit, burg për 40-vjeçarin

02 Prill, 2022



E njihja me emër tjetër. Më tha se ishte 27 vjeç dhe do fejohej me mua", ja çfarë deklaroi e dashura nga Kosova e Dumanit në gjyq, vëllezërit presin jashtë Gjykatës

02 Prill, 2022



VIDEO/ I rrethuar nga policë, ja momenti kur ish-deputeti Alqi Bllako del nga Gjykata me pranga në duar

02 Prill, 2022



A ka qenë Alqi Bllako në Kosovë për t'u arratisur? Ja si përgjigjet avokati i tij

02 Prill, 2022

KATEGORIA VIDEO




Nuk u ftua në ceremoninë e nderimit të martirëve, kryetari i PD së Shkodrës i zhgënjyer: Përjetova masakrat e 2 prillit

02 Prill, 2022



Mes Shqipërisë dhe Anglisë, deputeti socialist: Çdo javë jam me qytetarët e Dibrës! Marrëdhëniet me britanikët jo vetëm turistike, të fokusuara edhe në zhvillimet hekurudhore

02 Prill, 2022



Albana Vokshi deklaroi nga selia e PD: Edi Rama ideatori dhe autori kryesor i megaferës së shekullit me inceneratorët. Drejtësia ta hetojë

02 Prill, 2022




Basha president? Harxhi nga Korça: Nuk merrem me shaka të tillat! Bashkimi dhe vota çështjet kryesore të PD

02 Prill, 2022



"A më ke lindur ti?" përballja nënë-bijë, 70-vjeçarja: S'u martova kurrë, por në SOS u bëra nënë

02 Prill, 2022



GJKKO e la në burg, avokati i Alqi Bllakos: Ka përcjellë vetëm dokumentacionin për shkak të akteve që dalin nga Këshilli i Ministrave

02 Prill, 2022

